KRONIKË E ZEZË

Policia gjen armë e municion në një shtëpi në Zubin-Potok, arrestohet një person

20 mars 2023, 18:44

Shpërndaje në

Policia e Kosovës, ka njoftuar se në fshatin Kozarev në Zubin-Potok ka arrestuar një person të dyshuar për armëmbajtje pa leje.

Sipas njoftimit të Policisë, përmes të një bashkëpunimi efikas me njësitet e specializuara dhe ato të antidrogës, kanë pranuar informacione se në një lokacion në këtë fshat, në një shtëpi dyshohet për posedim të armëve dhe municionit.

"Njësitet kompetente policore nga stacioni policor Zubin Potok kanë ndërmarr veprime të menjëhershme policore dhe pas një pune hetimore dhe operative kanë arrit që në shtëpinë e dyshuar të gjejnë dhe sekuestrojnë si dëshmi/prova materiale: dy armë të gjata, me 208 fishekë, dy pushkë ajrore, dy kuti me sfera të pushkës, një revole, e tipit 'zastava' dhe dy karikatorë me 18 fishekë", thuhet në njoftim.

Lidhur me rastin thuhet se janë njoftuar njësitet kompetente rajonale të hetimeve Mitrovicë veri të cilat kanë dal në vendin e ngjarjes.

"Në konsultim me prokurorin kompetent është iniciuar rasti 'Mbajtje në pronësi, posedim, kontroll të paautorizuar të armës' dhe i dyshuari dërgohet në mbajtje për procedura të mëtejme ligjore", thuhet në njoftim.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

#ARME

TaboolaFeed

Ja si mund të mbani në kontroll mykun e këmbëve në kushte shtëpie
Blog | Sponsored
Lexo më shumë

Kolltuk masazhues profesional - 73% zbritje! Vetëm 55 000 Lek
megazbritje.al | Sponsored

77-vjeçari në Prizren u gjet i vdekur në një motel
Personi që është gjetur i vdekur të shtunën në Prizren është një 77-vjeçar. Zëdhënësi i Policisë për rajonin e Prizrenit, Shaqir Bytyqi, ka bërë të ditur se viktima ka vdekur në një ...
Kohanet



Online Jobs Might Pay More Than You Think
Online Jobs | Search Ads | Sponsored

TË TJERA

Ndalohet furgoni në Leposaviq, iu gjetën dy dhi e 21 keca pa dokumente

Arrestohet një person në Suharekë për dhunimin e një të miture

Një person në Jarinjë sulmon policin dhe ikën

Ylli shqiptar i rrjeteve sociale kërkon falje, thotë se nuk e kishte qëllim të rrezikonte dikë

Aksion në 10 barnatore, mbyllet një e intervistohen tre pronarë të tyre

Rasti i Sebahate Morinës, Gjykata Kushtetuese konstaton se i është shkelur e drejta për jetë

Therje me thika mes dy grupeve të nxënësve në një shkollë të Lipjanit

I kërkuari për kontrabandë kapet duke kryer të njëjtën vepër

Arrestohet në Pejë prindi që kanosi drejtorin e shkollës pasi iu suspenduan dy fëmijët

Viti, lirohet në procedurë një person që sulmoi fizikisht nënën, motrën dhe bashkëshortën

Prishtinë, shtetasja gjermane raporton se mori një letër kërcënuese

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfardo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe internetit a mediumi tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, Kohavision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjitha shkeljet e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.